REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 4988 Prot

Maliq, më 18.9.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr.____, datë 18.09.2025

Për

"Ngritjen e grupit të punës për proçesin e hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Maliq"

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", "Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030", si dhe Planit të Veprimit 2024-2026, në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës, miratuar me VKM nr 859, datë 26.12.2024, propozoj miratimin e këtij projekt-vendimi nga këshilli duke vendosur :

1. Të miratojë ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Maliq
2. Koordinator i grupit të punës përgjegjës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Maliq do të jetë Sekretari i Përgjithshëm.
3. Anëtarët e grupit të punës përgjegjës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Maliq do të jene si më poshtë:

- Drejtor i Financës e Buxhetit
- Koordinator i riskut, menaxhimit financiar dhe kontrollit
- Drejtori Juridik dhe Cështjeve Ligjore
- Drejtor i të Ardhurave
- Pergjegjes Auditi i Brendshëm)
- Drejtor Planifikimi,Kontrollit e Zhvillimit të Territorit
- Drejtor i Pronave Publike
- Drejtor Shërbimi Social
- Drejtor Agjensia e Shërbimeve
- Përgjegjës Zyra e Integrimit Evropian
- Përgjegjës Burimet Njerëzore dhe Marëdhënieve me Publikun
- Koordinator performance dhe bashkëqeverisje
- Përgjegjes Sektori Emergjencat Civile
- Përgjegjës Sektoi I Teknologjise dhe Informacionit
- Kryeinspektor ndërtimor

- Inspektor Zjarrfikës
- Kryeinspektor Policie
- Sekretar Keshilli Bashkiak

4. Grupi i punës për hartimin e planit të integritetit, brenda 30 ditëve, harton një program pune për hartimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Maliq.

5. Grupi i punës për integritetin është i detyruar të hartojë një plan për integritetin e institucionit, në mbështetje të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe ia dorëzon këtë plan Kryetarit të Bashkisë Z. Gëzim Topçiu, brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij urdhri.

6. Të gjithë punonjësit e Bashkisë Maliq janë të detyruar t'i sigurojnë grupit të punës të gjithë ndihmën, mbështetjen dhe informacionet e nevojshme në procesin e hartimit të planit të integritetit për institucionin tonë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e gjithë administrata e bashkisë dhe njësia vartëse.

8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Këshilli Bashkiak.

Konceptoi : J.Xhialli Sekretar i Pergjithshem

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ